Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/1078
Datë 08.10.2019

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2019 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Validohet dhe akreditohet Qendra për Studime Univeristare e Forcës së Sigurisë së Kosovës (QSU), me adresë, Kazerma "Adem Jashari" në Prishtinë, për periudhën tri vjeçare 30. 09. 2019 deri 30.09.2022 me kualifikimin:

   1.1. Nëntoger në Forcat e Armatosura, Niveli V sipas KKK me 120 kredi të AAP

2. Numri i kandidatëve që lejohet për grup duke u bazuar në hapësirën fizike, në pajisjet dhe mjetet e punës për ushtrimin praktik është 25 kandidatë.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit, i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime, janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të kualifikimit/modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucion ofrues dhe/ose Vlerësues

dhe lëshues të kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

3. Vendimi i dërgohet:
   - Qendra për Studime Univeristare (QSU)
   - AKK

Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema